

VENDIM
Nr. 16, datë 10.1.2018

**MBI MIRATIMIN E “RREGULLAVE
PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË
TË DHËNAVE DHE PROCEDURËN
PËR AKSESIN E FURNIZUESVE NDAJ
TË DHËNAVE TË OPERATORIT
TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draftrregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike, konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE përcakton formatin e të dhënave të OSHEE-së dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave.

- Në bazë të nenit 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i siguron, pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi.

- Mbështetur në “Rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, pas marrjes së vendimit nr. 159, datë 4.10.2017, “Për fillimin e procedurës për miratimin e draftrregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, ERE publikoi në shtypin e shkruar njoftimin në lidhje me sa më sipër, duke ftuar të gjitha palët e interesit të shprehin komentet e tyre.

- ERE, me shkresën nr. 666 prot., datë 10.10.2017, dërgoi draftin e këtyre rregullave për marrjen e mendimit palëve të interesit: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqatës AAES, shoqatës FIAA, shoqatës ACERC, OSHEE sh.a., OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar për marrjen e komenteve të palëve të interesit, mbi sa parashikuar në draftin e kësaj rregulloreje, rezultoi që kanë mbërritur komente nga shoqata AAES, si dhe OSHEE sh.a.

- ERE, me shkresën nr. 666/2, datë 2.11.2017, iu përgjigj shoqatës AAES, duke sqaruar se komentet e përcjella sa më sipër, nuk gjejnë zbatim në këtë rregullore dhe propozimet e AAES-së, kufizojnë të drejtat e furnizuesve në raport me aksesin në të dhënat e OSHEE sh.a.

- Pas përfundimit të afatit për marrjen e komenteve, u depozituan në ERE, me shkresën nr. 666/3 prot., datë 10.11.2017, komentet e shoqërisë OSHEE sh.a.

- Pas marrjes së komenteve të OSHEE sh.a., ERE, në datë 4.12.2017, organizoi një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve të interesit, ku u diskutua dhe u dakordësua se cilat nga propozimet e palëve mund të pranoheshin.

- Palët u sqaruan mbi legjitimitetin e propozimeve të tyre dhe ranë dakord mbi draftin e ndryshuar të kësaj rregulloreje.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregullat për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (bashkë-lidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

RREGULLAT

PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË TË DHËNAVE DHE PROCEDURËN PËR AKSESIN E FURNIZUESVE NDAJ TË DHËNAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 1

Autoriteti

Këto rregulla hartohen në zbatim të nenit 69, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të ligjit nr. 9501, datë 3.4.2006, “Për ratifikimin e traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë”.

Neni 2

Objekti

1. Këto rregulla përcaktojnë procedurat dhe kërkesat për informacion, lidhur me aksesin në kohë të të dhënave të OSSH sh.a. mbi konsumin e energjisë elektrike në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

2. Këto rregulla, gjithashtu, përcaktojnë në mënyrë të detajuar detyrimet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në lidhje me vënien në dispozicion të të dhënave që lidhen me konsumin e energjisë elektrike nga klientët fundorë dhe çështjeve të tjera të nevojshme për publikimin e tyre.

Neni 3

Aksesi i të dhënave

1. OSSH sh.a. do të sigurojë për furnizuesit, si pjesë të shërbimit të ofruar prej saj, aksesin në të dhënat e konsumit të energjisë elektrike nga klientët.

2. Operatori/OSSH sh.a. do të sigurojë këtë shërbim nëpërmjet një faqeje interneti të dedikuar, por edhe nëpërmjet çdo qendre të kujdesit të klientit, ku furnizuesi paraqitet me kërkesë për të dhëna. Historiku i konsumit është në dispozicion përmes faqes së internetit apo nëpërmjet dokumentit të vënë në dispozicion nga qendrat e kujdesit të klientit apo edhe çdo formë tjetër të dërgimit të të dhënave, përfshirë, por pa u kufizuar, përmes mesazheve telefonike e forma të tjera të arritshme nga publiku.

3. Informacioni historik, që përfshin konsumi vjetor për jo më pak se një periudhë që përfshin pesë vitet e fundit, është një e drejtë e garantuar për të gjithë furnizuesit nga legjislacioni. Për më tepër, të dhënat mbi baza mujore e informacionit sigurohen nga OSSH sh.a. te furnizuesi.

4. OSSH sh.a. i siguron furnizuesit edhe të dhënat e energjisë elektrike mbi baza orare për të gjithë klientët kur pajisjet e matjes e lejojnë një përlllogaritje të tillë.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të dorëzojë te furnizuesi të dhënat e kërkuara, sipas kësaj rregulloreje jo më vonë se 1 (një) ditë kalendarike pas marrjes së kërkesës nga një furnizues. Format i kërkesës do jetë sipas aneksit nr. 1 të kësaj rregulloreje.

6. Furnizuesi që kërkon të dhënat si më sipër, duhet që më parë të ketë nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti, nëpërmjet së cilës garanton përmbushjen e detyrimeve ligjore duke përfshirë, në veçanti, legjislacionin mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 4

Detyrime të tjera

1. OSSH sh.a. do të krijojë kode që përcaktojnë rregullat për përdorimin dhe hyrjen në të dhënat e përcaktuara sipas këtyre rregullave.

2. Furnizuesi nuk ka akses të drejtpërdrejtë në programet e aksesit, por do të ketë akses nëpërmjet fjalëkalimit personal në të dhënat e konsumit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a., duke përdorur një portal të përbashkët për të gjithë furnizuesit.

3. Në çdo rast, ky portal do të sigurojë identifikimin individual elektronik të furnizuesit që akseson të dhënat, të cilit i përkon një kod unik që do të gjenerohet për çdo furnizues të regjistruar e që ka një kontratë dhe marrëveshje konfidencialiteti me OSSH sh.a..

4. Për të gjitha rastet kur kërkohet nga furnizuesi, OSSH sh.a. do të ofrojë të dhëna sipas formatit mbi baza orare, mujore, tremujore dhe vjetore.

5. Informacioni mbi këto të dhëna, përditësohet jo më shumë se pesë ditë (kalendarike) pas ditës së konsumit/të fundit të regjistruar, kur pajisjet e matjes lejojnë matjet orare.

6. Në çdo rast tjetër, përditësimi i të dhënave do t'i korrespondojë muajit të fundit të regjistruar me matje.

Neni 5
Interpretimi

1. Në rast se një çështje nuk është trajtuar në këtë rregullore, ERE do të vendosë rast pas rasti dhe do të nxjerrë udhëzimet, sipas kërkesave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Termat dhe përkufizimet e përdorur në të do të kenë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 6
Amendime të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të bordit të ERE-s, si dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 7
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore, “Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, hyn në fuqi jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i këtyre rregullave nga ERE.
2. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave, në çdo rast OSSH sh.a. do të sigurojë këtë akses te furnizuesit, sipas formave të tjera të parashikuara në këtë rregullore.

ANEKSI
FORMATI I TË DHËNAVE

NR. KODI UNIK I KËRKESËS	
KËRKUESI	
DATA E REGJISTRIMIT TË KËRKESËS	
KODI I KLIENIT, OBJEKT I KËRKESËS NGA FURNIZUESI	
TË DHËNA MBI KONSUMIN VJETOR/DITOR /MUJOR/ORAR SIPAS KËRKESËS	
NËSE NUK SPECIFIKOHET NË KËRKESË, TË DHËNAT DO TË PËRFSHIJNË KONSUMIN VJETOR TË 5 VITEVE TË FUNDIT	
AFATI I TRAJTIMIT	
DETYRIMI PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE SIPAS KËRKESAVE TË LIGJIT “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”	